


ZGJEDH MË TË MIRËT



PËR NJË TË ARDHME TË NDRITUR

DËSHIRAT E DEMOKRATËVE

GETUAR (10), ELJESA (10), RUMEJSA (10), BLENDINA (11), BESART (10), ERINA (10), DORIAN (10)



Qytetarët në demokraci janë të lirë, aktiv dhe të edukuar. Këta po që janë qytetarë aktiv!

Të gjithë demokratët kanë dëshira dhe të drejta. Pasi që ne jetojmë në Kosovë dhe Kosova është shtet demokratik, edhe ne kemi dëshira dhe të drejta. Nëse dëshironi të dini cilat janë këto, atëherë lexoni artikullin

Ne sot kishim kënaqësinë të jemi pjesë e Punëtorive të Demokracisë. Gjatë diskutimit tonë ne mësuam për demokracinë. Disa pjesëtarë të grupit nuk kishin dëgjuar për demokracinë më parë. Fatmirësisht disa të tjerë kishin dëgjuar për këtë koncept. Demokracia lindi në Athinë, në vitin 507 para lindjes së Krishtit. Në atë kohë Athina nuk ka qenë siç është sot. Atëherë Athina ishte ndër qytet-shtetet me të famshme të Greqisë. Mirëpo, të drejtën për të marrë vendime e kishin vetëm të pasurit e Athinës. E ndërsa, të moshuarit, fëmijët, të varfërit dhe jo vendasit nuk mund të merrnin pjesë në takimet vendimmarrëse. Kjo ishte demokraci direkte. Pas lindjes së Krishtit dhe pas mijëra vjetësh, demokracia ndryshoi. Të gjithë tani kemi të drejta dhe liri. Kjo quhet demokraci përfaqësuese. Sot kjo de-

mokraci është demokraci e plotë, për të cilën shumë njerëz kanë punuar me vite. Elementet e demokracisë janë: toleranca, drejtësia, mirësjellja, liria, respekti dhe paqja. Këto elemente janë shumë të rëndësishme për neve dhe për zhvillimin e demokracisë. Qytetarët, siç po e shihni, janë tejet me vlerë në një shtet demokratik. Ata mbrohen nga ligji dhe nga institucionet e tyre, pa asnjë dallim.

Në vijim do t'iu tregojmë për një dëshirë tonën. Ne si qytetarë dhe nxënës aktiv, dëshirojmë të kërkojmë diçka nga përfaqësuesit tanë, të cilët punojnë në komunën e Prishtinës. Pasi që në shkollën tonë është një bibliotekë, e cila nuk ka shumë libra, ne kërkojmë nga Komuna që të shtoj edhe më shumë libra në raftet e bibliotekës sonë. Ndërsa, nga përfaqësuesit e komunës së Klinës kërkojmë që të ndërtojnë shkolla të reja, sepse shkollat ekzistuese janë të ndërtuara që nga vitet '80. Kjo nuk është edhe aq e mirë për nxënësit, të cilët siç na treguan neve, kanë nevojë për kushte më të mira që të mësojnë më shumë. Ju faleminderit.





Ne jemi të lumtur që ishim pjesë e „Demos-ti“



Si dhe jemi të gëzuar sepse jemi demokratë të vërtetë


KUVENDI I JEP STRUKTURË JETËS SONË

VLERA (11), RONA (10), BESA (10), DONISA (10), FATLINDA (10), RIAD (10), ETNOR (10), ERONA (10)



A e keni menduar ndonjëherë se cili është ai institucion, i cili i jep strukturë jetës sonë? Ky institucion është Kuvendi, i cili me punën dhe përkushtimin e tij siguron që të gjithë qytetarët të jetojnë një jetë në bazë të ligjeve të miratuara aty

Përfitues të ligjeve të miratuara nga Kuvendi jemi ne qytetarët. Me vullnetin tonë të lirë, nga mosha e papaparë me ligj, zgjedhim personat të cilët ne mendojmë se janë më adekuat për të udhëhequr shtetin tonë. Personat në fjalë quhen deputetë, të cilët gjithsej në numër janë 120. Ata punojnë dhe veprojnë në Kuvendin e Kosovës. Përpos saj, deputetët propozojnë dhe miratojnë ligje. E ligjet janë rregulla të shkruara, të cilat duhet të zbatohen nga të gjithë. Në rast të shkeljes së ligjeve, shteti ynë reagon dhe merr masat e duhura ndaj personave të cilët kanë kryer këtë shkelje. Detyra kryesore e ligjeve është që të sigurojnë të ardhme të mirë dhe të sigurt për të gjithë. Këtë mund ta dëshmojmë edhe me njërin prej ligjeve të miratuara në Kuvend. Ligji për të cilin po flasim është ligji për ndërtim. Në bazë të këtij ligji, përkatësisht neni 3 i tij thotë se: „Ndërtesat duhet të vendosen, ndërtohen, ndryshohen, rënohen dhe mirëmbahen, në mënyrë që të mos rrezikojnë sigurinë dhe rendin publik, veçanërisht jetën dhe shëndetin e njerëzve, mjedisin, qëndrueshmërinë e objekteve fqinje dhe instalimet publike“. E shihni pra qytetarë të nderuar, se çdo ligj përmend me kujdes sigurinë dhe rendin publik? Pikërisht kjo tre-



Edhe lirinë e kemi të garantuar me ligj

gon se sigurimi i mirëqenies së qytetarëve të Kosovës është principi bazë i Kuvendit. Andaj, qytetarë të nderuar, dikush punon për të ardhmen tuaj, por edhe ju duhet ta ndihmoni punën e tyre, duke bërë zbatimin e ligjeve. Ne jemi të vegjël, por shumë të interesuar për të ardhmen tonë. Prandaj, na ndihmoni edhe ju që të kemi një vizion edhe më të mirë për të ardhmen. Së bashku ne mund të arrijmë suksesin.



Zbatimi i ligjeve na ka frymëzuar për jetë

NA INFORMON PËR GJITHÇKA, MEDIA

VINESA (10), SHPËTIM (11), RIJONA (10), YLL (10), JONA (9), VULLNET (10), ANDUENA (10),
GENITA (10)

Sot jemi përfaqësues të medias dhe kështu do t'iu njohojmë më shumë se çka është ajo

Përshëndetje të dashur lexues. Ne jemi gazetarët më të rinj të shtetit të Kosovës. Sot do t'iu tregojmë për median dhe rëndësinë e saj në demokraci. Media na ndihmon të jemi të informuar për ndodhitë brenda dhe jashtë vendit.

Kemi lloje të ndryshme të medias, prej të cilave ne marrim informacione. Të gjitha këto hyjnë në dy grupe të medias: media e shkruar dhe ajo elektronike. Në media të shkruara bëjnë pjesë: revistat, romanet, lekturat, gazetatat, etj. Ndërsa, në media elektronike bëjnë pjesë: telefoni, kompjuteri, radio, televizioni, etj. Pothuajse në çdo shtet të botës, ka media të cilat financohen nga buxheti i shtetit, e të cilat ne i quajmë media publike. Por, gjithashtu kemi edhe media private, të cilat vetëfinancohen nga drejtuesit e tyre.

Çdo qytetar i cili jeton në një shtet demokratik, ka të drejtën e informimit të saktë. Prandaj, edhe ne si qytetarë të Kosovës, e posedojmë këtë të drejtë.



Ndonëse jemi të vegjël, ne thuhet se çdo ditë e përdorim median për nevojat tona shkollore. Po e ndajmë me ju një rast ku media na ka ndihmuar shumë. Neve na pëlqen shumë lënda „Njeriu dhe Natyra“. Aty, ne kemi mësuar për gjarprin. Mrëpo, si nxënës të etur për informata që jemi, ne u konsultuam me mësuesen dhe vendosëm të kërkonim informata më të thella për një lloj të veçantë të gjarprit. Më pas, na lindi ideja për

të bërë një projekt në lidhje me këtë temë. Kështu, ne vendosëm që, përpos informatave, të merrnim fotografi nga interneti të këtij lloji të gjarprit. Në fund, të gjitha të dhënat i vendosëm në programin „PowerPoint“. Nga e gjithë puna jonë që ne e prezentuam para mësueses, çdo gjë shkoi me sukses dhe mësuesja u nda shumë e kënaqur me atë që ne kishim realizuar. Me këtë shembull, ne duam të theksojmë rëndësinë e medias dhe se sa na e lehtëson punën tonë në aspektin informues dhe atë hulumtues.

Ne tanimë jemi mishëruar me median dhe e vlerësojmë atë shumë. Andaj, me këtë artikull ne iu ftojmë të gjithë juve lexues të dashur të lexoni sa më shumë. Kështu, ju vini deri tek e vërteta për atë se çka iu intereson të dini.



Ne jemi këtu në emër të medias



Ilustrime të punuara nga ne: media të shkruara dhe ato elektronike

Më poshtë do të mund të lexoni për demokracinë, procesin zgjedhor dhe disa rregulla të këtij procesi kaq të rëndësishëm. Shpresojmë që këto informata do t'iu shërbejnë në zgjedhjet e radhës

Demokracia është formë e qeverisjes, e cila është forma më e përhapur në botë. Në demokraci fuqia i takon popullit. Qytetarët, në këtë rast janë ata, të cilët e shfrytëzojnë fuqinë e tyre për t'i zgjedhur përfaqësuesit e shtetit. Zgjedhja e tyre bëhet me anë të votave të qytetarëve. Çdo qytetar i cili arrin moshën 18 vjeçare mund ta shfrytëzojë të drejtën për të votuar.


Në Kosovë, kemi dy lloje të zgjedhjeve. Të parat, për të cilat do të flasim janë zgjedhjet qendrore apo parlamentare. Zgjedhjet qendrore janë ato zgjedhje, ku qytetarët votojnë për kandidatët për deputetë dhe në atë mënyrë, pasi që kanë marrë votat e tyre, ata përfaqësojnë popullin.

Zgjedhjet e tjera janë zgjedhjet lokale apo komunale, ku qytetarët e secilës komunë, votojnë për kandidatin për kryetar të komunës, si dhe për asamblistët. Kryetari/ja i/e komunës ka shumë detyra. Ai/ajo duhet të përpiqet t'i zgjidh problemet e komunës, qytetarët e

së cilës ai/ajo përfaqëson. Por, në zgjidhjen e atyre problemeve, kryetarit të komunës i ndihmojnë edhe asamblistët.

Në këto zgjedhje, rregullë e procesit zgjedhor është që çdo qytetar duhet të votoj për kandidatët nga komuna e tij/saj. Një qytetar i Gjilanit nuk ka të drejtë të votojë për kryetarin e komunës së Prishtinës dhe anasjelltas. Gjithashtu, qytetarët duhet të votojnë në vendvotimin, të cilit i përkasin. Kemi raste specifike kur qytetarëve iu lejohej të votojnë në një vendvotim tjetër, por kjo ndodh vetëm nëse ata nuk kanë mundësi të shkojnë në vendvotimin e tyre. Kjo formë e votës quhet votë me kusht.

Lexues të dashur të kësaj gazete, do të gëzoheshim shumë nëse këto informata do t'iu hynin në punë edhe juve. Edhe ne ishim të interesuar të dijmë më shumë për zgjedhjet dhe median. Sot e kuptuam edhe rëndësinë e tyre.



Ndonëse kohëve të fundit ne përdorim shumë median elektronike, media e shkruar nuk duhet të humbas asnjëherë



Nxënësit duke zhvilluar aktivitete kreative në grupin e vogël



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Zenel Hajdini“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë